



Ligji i Amnistisë dhe Përfituesit

Studim mbi ri-përfshirjen në sjellje kriminale të
personave që përfituan nga Ligji i Amnistisë

Punoi: Blerina Gjerazi
Majlinda Tafaj

Qershor 2014

PËRMBAJTA

1. Hyrje

- 1.1 Konteksti i studimit
- 1.2 Kufizimet e studimit

2. Përkufizimi i recidivizmit

- 2.1 Recidivizmi dhe problematika në Drejtësinë Penale
- 2.2 Faktorët e riskut për recidivizmin

3. Të dhëna të përgjithshme të Sistemit të Burgjeve mbi recidivizmin

- 3.1 Numri i recidivistëve nga viti 2010-2013

4. Të Amnistuarit në Sistemin e Burgjeve

- 4.1 Të dhëna mbi personat që përfituan nga amnistia
- 4.2 Probabiliteti i ri-përfshirjes në sjellje kriminale

5. Konkluzionet/ Rekomandime

Aneks 1

Tabelë me të dhëna mbi veprat e amnistuara, numrin e personave që përfituan sipas Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

I. HYRJE

Për vite me radhë, në vende të ndryshme të botës studimet mbi recidivizmin kanë qenë ndër aspektet kryesore kërkimore në fushën e kriminologjisë. Metodatat të cilat përdoren për vlerësimin e nivelit të recidivizmit, mund të ndahen në dy kategori¹:

1. Në studimet retrospektive veprat penale të kryera më herët dhe numri i tyre, observohet në rast të një grupi të caktuar personash. Një nga teknikat më të njohura për vlerësimin e recidivizmit është mbi bazën e të dhënave të personave të cilët janë duke vuajtur dënimin në burgje.
2. Kategoria e dytë ka të bëjë me studimin zinxhir, që lidhet me recidivizmin si sjellje, si rrjedhojë e një ngjarje të veçantë gjatë një periudhe të caktuar kohe.

Ky studim do të fokusohet në vlerësimin e recidivizmit për personat e dënuar të cilët kanë përfituar nga ligji nr. 22 datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie”. Duke qenë se për herë të parë zhvillohet një studim i tillë në Sistemin e Burgjeve, eksperiencia e vendeve të tjera, është marrë si bazë për të ndërtuar këtë studim. Bazuar në dy kategoritë e sipërpërmendura, është kryer një vlerësim i të dhënave të personave të cilat kanë përfituar nga amnistia, ku pjesë e rëndësishme e kërkimit kanë qenë nëse kanë qenë përsëritës krimi, llojin e krimi të ri-kryer dhe shkaqet kryesore të ri-përfshirjes në sjellje kriminale.

1.1 Konteksti i studimit

Më 10 prill 2014, hyri në fuqi ligji nr. 22 datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie”. Principet themelore të ligjit bazoheshin në të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të individit, si dhe nisur nga arsyet social-ligjore të humanizmit, ri-integritimit social, rehabilitimit social, ndryshimeve pozitive në jetën e të dënuarve, arritjes së standardeve evropiane në sistemin penitenciar, si dhe legjitimitetit të duhur kushtetues-ligjor në vendet e vuajtjes së dënimit.

Sipas ligjit përfitonin amnisti:

a) personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, për dënime të dhëna deri në datën 30 nëntor 2013, pa varësisht kohës së mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

¹ www.just.ee/recidivism

b) personat e dënuar, ndaj të cilëve gjykata, me vendim të formës së prerë, ka caktuar një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

c) personat e dënuar me gjobë, për pjesën e pashlyer të saj, pavarësisht masës së gjobës, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

ç) personat e dënuar me burgim, të cilëve, në datën 30 nëntor 2013, u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

d) të dënuarat femra, që në datën 30 nëntor 2013 janë bars ose mbi moshën 55 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

dh) të dënuarit meshkuj, që në datën 30 nëntor 2013 janë bars ose mbi moshën 60 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

e) të dënuarit me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë bars ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre, që janë dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 101, 139, 140 e 141 të kodit penal.

Përzgjedhja e kategorisë së personave që përfitojnë amnisti, u krye bazuar në këto kritere:

a. lloji dhe masa e dënimit;

b. koha e mbetur e dënimit; mosha aktuale e personit të dënuar;

c. mosha e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale; si dhe

d. rrezikshmëria e ulët e personit apo veprës penale.

Aplikimi i amnistisë në Sistemin e Burgjeve, filloi menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit, ku sipas dispozitave ligjore, përfituan **813 persona**² me liri të kufizuar.

1.2 Kufizimet e studimit

Duke qenë se procesi i vlerësimit për ri-përfshirje në krim të personave që kanë përfituar nga amnistia, u krye pas lirimit të këtyre personave, të dhënat e këtij studimi, bazohen në të dhënat e dosjes personale të dënuarve dhe paraburgosurve dhe jo në intervista të drejtpërdrejta me ta apo në të dhëna të tjera empirike. Kështu që informacioni që lidhet me kushtet socio-ekonomike, kulturore dhe të përgjithshme, bazohet në të dhënat e reflektuara në dosjet personale të burgosurve të amnistuar, ku në disa raste mungonin.

² Të dhënat statistikore të Sistemit të Burgjeve, datë 10.04.2014

Intervistat e drejtpërdrejta me personat që kanë përfituar nga amnistia, do të ndikonin në perceptimin më të gjerë të mundësive për ri-përfshirje në sjellje kriminale dhe matje më reale të numrit të personave të predispozuar për tu ri-arrestuar.

Ky studim nuk vlerëson performancën e burgjeve bazuar në nivelin e recidivizmit. Bazuar në faktorët socialë, gjinisë dhe sjellje të mëparshme kriminale, ky studim merr përsipër të kryejë një vlerësim të probabilitetit të personave që mund të rikthehen në sistemin e burgjeve.

II. PËRKUFIZIMI I RECIDIVIZMIT

Recidivizmi apo ri-përfshirja në sjellje kriminale me pasojë, përsëritjen e një veprë penale, është një nga konceptet themelore në drejtësinë penale. Kryesisht, i referohet rikthimit të një personi në sjellje kriminale, pasi personi ka përfunduar një dënim të mëparshëm. Përsëritja matet nga veprat penale të cilat rezultojnë në ri-arrestim të personit, ri-dënim, ose ri-kthim në burg brenda një periudhe tre vjeçare pas lirimit të burgosurit.

Raporti i Studimit të Politikave për Ri-kthimin³ në kuadër të sjelljes kriminale, i referohet ri-arrestimit, ri-dënimin ose ri-burgimit të ish-të dënuarve brenda një periudhe 3-vjeçare nga lirimi apo përfundimi i dënimin të mëparshëm. Recidivizmi është përkufizuar si “rikthim në zakonet e mëparshme kriminale, veçanërisht pas një dënimin”, pra recidivizëm do të thotë kryerjen e një krimi nga një individ, që më parë ka kryer të paktën një veprë tjetër penale.

Rritja e numrit të recidivizmit, i referohet përgjithësisht probabilitetit se personi i liruar me kusht, plotësim kohe, amnisti, apo forma të tjera, gjatë qëndrimit në një institucion të mbyllur, nuk ka qenë i përgatitur për të përballuar plotësisht dhe denjësisht qëndrimin jashtë, ku nuk përjashtohen kushte psiko-sociale e ekonomike.

2.1 Pse recidivizmi duhet parë si një shqetësim serioz në Drejtësinë Penale?

Recidivizmi është një fenomen i rëndësishëm në drejtësinë penale, veçanërisht kur lidhet me termat (pa) aftësi, parandalim i veçantë dhe rehabilitim.⁴

³ Re-entry Policy Study Report, Indiana City, 2013

⁴ Cann, J., et al (2003). Understanding What Works: accredited cognitive skills programmer for adult men and young offenders. Home Office. London. Findings 226.

(Pa) aftësia i referohet efekteve që ka ligji dhe kushtet për të ndaluar personat për kryerjen e një vepre penale dhe largimit të një shkelësi nga komuniteti;

Parandalimi specifik, përdoret për të treguar nëse sanksionet i ndalojnë njerëzit nga kryerja e krimeve të mëtejshme, pasi dënimi ka përfunduar ose është shpallur;

Rehabilitim, përdoret për të treguar ndikimin që ka një program për uljen e krimit, ose “riparimin” e individit, nëpërmjet adresimit të nevojave dhe deficienteve të tij/saj.

Në një aspekt më të gjerë, recidivizmi shikohet edhe si një formë për të matur efektivitetin e programeve rehabilituese në burgje dhe për të kryer një vlerësim të përgjithshëm të tyre. Në shumë vende të botës matja e recidivizmit kryhet si një proces i veçantë dhe studim i thelluar, në mënyrë që të përcaktohet efektiviteti i menaxhimit të burgjeve dhe shërbimeve të tij. Ligjzbatuesit dhe politikëbërësit i konsiderojnë të dhënat e recidivizmit si kritere për vlerësimin e performancës së sistemit dhe korrektimin e tij. Më tej, është e nevojshme të analizohen faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e nivelit të recidivizmit, në mënyrë që të shërbejnë si një fazë për vlerësimin e politikave apo programeve dhe efektivitetin e tyre.

2.2 Faktorët e riskut për recidivizmin

Studime të ndryshme shkencore kanë dokumentuar disa faktorë që ndikojnë në nivelin e recidivizmit. Këto përfshijnë karakteristika personale si moshën, gjinia, kohëzgjatja dhe ashpërsia e historisë kriminale, niveli i edukimit dhe aftësive, si dhe sjellja në burg. Gjithashtu, mendohet se, faktorë të tjerë, si kohëzgjatja e burgimit, mund të ndikojë në nivelin e recidivizmit.

Faktorët e recidivizmit janë pothuajse të njëjta për të gjitha kategoritë e të burgosurve. Normat e recidivizmit lidhen kryesisht me mundësitë e punësimit për ish të dënuarit. Aftësia e tyre për të siguruar të ardhura për vete dhe për familjet e tyre shpesh pengohet nga paaftësia e tyre për të gjetur punë. Përveç kësaj pengesë, punëdhënësit zakonisht kufizojnë mundësinë edhe më tej kur zbulojnë se një person ka një të kaluar kriminale. Një arsye tjetër për numrin e madh të përsëritësve është se shumë ish-të dënuar kthehen në të njëjtin mjedis ku kanë kryer krimin, ku ata janë subjekt i presioneve, pikëpamjeve negative të shoqërisë dhe stereotipeve. Në raste të tjera, individët kanë qenë jashtë shoqërisë për periudha të gjata kohore, saqë nuk posedojnë aftësitë jetësore për të funksionuar me përgjegjësi në shoqëri apo të asimilohen në të. Edhe në qoftë se u jepen mundësi të shumta, shumë individë nuk do të mund të përfitojnë prej tyre. Nëse marrim si shembull

një 19-vjeçar i cili merr një dënim 25 vjet dhe lirohet në moshën 44 vjeçare, i mungojnë aftësitë parësore dhe do ta ketë tejet të vështirë për tu përshtatur dhe jetuar në komunitet.⁵

III. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SISTEMIT TË BURGJEVE MBI RECIDIVIZMIN

Të dhënat statistikore që mblidhen në sistemin e burgjeve lidhur me recidivizmin, grupohen në dy kategori: a. recidivistë specifik dhe b. recidivistë të përgjithshëm. Në grupin e recidivistëve specifik, përfshihen të dhëna statistikore të kryerjes së të njëjtës vepër penale. Në kategorinë e recidivistëve të përgjithshëm, mbahen të dhëna statistikore, mbi kryerjen e veprave të tjera penale, krahasuar me veprën fillestare të arrestimit/burgosjes/dënimin.

Të dhënat periodike statistikore mbi recidivizmin, kanë filluar të mblidhen, grumbullohen dhe përpunohen në tetor të vitit 2009. Në vitet e mëparshme të dhënat mblidheshin në mënyrë sporadike dhe jo të standardizuara. Bazuar në zhvillimet e sistemit të burgjeve dhe nevojës për krijimin e bazave të dhënave statistikore të gjitha kategorive, sipas specifikës, ndarjes dhe nëndarjeve të dhënave, u krijua një format i unifikuar i të dhënave statistikore për mbajtjen dhe raportimin e tyre nga të gjitha IEVP. Kategori e veçantë e formatit, ishte raporti i të dhënave mbi numrin e të burgosurve të cilët ishin ri-arrestuar ose ri-dënuar brenda sistemit të burgjeve, ku specifikohet lloji i veprës së kryer dhe nëse personi është arrestuar/dënuar për të njëjtën vepër.

Baza e të dhënave mblidhet, grumbullohet dhe raportohet nga specialistët e kartotekës të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale. Duke qenë se në institucionet e varësisë nuk ka një strukturë të veçantë dhe të posaçme që merret me mbledhjen dhe mbajtjen në mënyrë specifike të dhënave statistikore, shpeshherë krijohet vështirësi operacionale dhe metodike për mbajtjen e të dhënave dhe mënyrën e raportimit të tyre sipas formateve të standardizuara.

3.1 Numri i recidivistëve dhe kategoria nga viti 2010-2013


Referuar të dhënave të katër viteve të fundit (2010-2013) të recidivizmit⁶, vihet re se ka një dinamikë të luhatshme të numrit të recidivizmit sipas kategorive nga viti në vit. Në vitin

⁵ Hanson, R. K. (2009). The psychological assessment of risk for crime and violence. *Canadian Psychology/ Psychologie canadienne*, 50, 172-182.

2010, janë regjistruar 427 raste të recidivizmit; në vitin 2011, 389 raste; në vitin 2012 janë shënuar 375 raste dhe në vitin 2013, 425 raste. Të dhënat e tabelës së mëposhtme tregojnë, se pjesa më e madhe e të dënuarve janë ri-arrestuar për kryerjen e veprave të tjera penale, krahasuar me veprën e dënimit të mëparshëm. Faktorët dominues për ri-përfshirje në sjelljet kriminale janë renditur faktorët psiko socialë dhe ekonomik. Megjithatë, studime më të thelluara nevojiten për validimin e këtyre faktorëve.

Tab. 1 Numri i recidivistëve nga viti 2010-2013 sipas ndarjes: të përgjithshëm dhe specifik

Numri i recidivistëve sipas viteve dhe kategorisë				
Recidivistë/Vitet	2010	2011	2012	2013
Të Përgjithshëm	227	224	217	282
Specifik	209	165	158	143



Të dhënat e tabelës tregojnë se krahasuar me vitin 2010⁷, në vitin 2011 dhe vitin 2012 ka një ulje të lehtë; **-1.3%** është ulur numri i recidivistëve të përgjithshëm në 2011 krahasuar me vitin 2010 dhe **- 4.6%** është ulur në vitin 2012, krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2013, vihet re një rritje e nivelit të recidivizmit të përgjithshëm, në krahasim me vitet e

⁶ Sektori i Raportimit, Statistikave dhe Kartotekës i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

⁷ Viti 2010 është marrë si viti bazë krahasues, pasi është viti në të cilin ka filluar mbajtja periodike e të dhënave mbi recidivizmin

mëparshme. Krahasuar me vitin 2010, vihet re një rritje me **19.5%** e recidivizmit të përgjithshëm.

Treguesit për recidivistët specifik, pra për personat të cilët janë arrestuar për kryerjen e të njëjtës vepër penale, për periudhën 2010-2013, krahasuar me të dhënat e recidivistëve të përgjithshëm, kanë një diferencë jo shumë të lartë. Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2011 është shënuar një ulje me -26% të personave të cilat janë arrestuar për të njëjtën vepër penale. Në vitin 2012, vihet re një ulje me -32% dhe në vitin 2013 është ulur -46%. Sipas të dhënave vihet re se ka një tendencë më të lartë, që personat të cilët ri-përfshihen në sjellje kriminale pas lirimit të tyre nga burgu, mund të kryejnë krime të ndryshme nga vepra fillestare e dënimit.

IV. TË AMNISTUARIT NË SISTEMIN E BURGJEVE

Siç është përmendur edhe më sipër, më 10 prill 2014, hyri në fuqi ligji nr. 22 datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie”. Konceptet kryesore të ligjit përfshinin:

- Dënimi penal duhet të jetë reagimi i fundit shtetëror ndaj sjelljeve të individëve, të përcaktuara si devijime social-ligjore;
- Prej kohësh, teoritë juridiko-sociale mbi qëllimin e dënimit kanë evoluar, nga koncepti i hakmarrjes dhe ndëshkimit ndaj autorit, drejt konceptit të riedukimit dhe rehabilitimit të tij. Këto koncepte përbëjnë idetë themelore të drejtësisë bashkëkohore rehabilituese;
- Qeveria shqiptare është e përkushtuar të rivendosi shtetin e së drejtës dhe sigurinë ligjore në vend. Për këtë, është e nevojshme të rivemë në lëvizje makinerinë e drejtësisë dhe organeve ndihmëse të saj përmes reformave të mëdha.

4.1 Të dhëna mbi personat që përfituan nga amnistia

Në funksion të arritjes së qëllimit të dënimit, bazuar në të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të individit, si dhe nisur nga arsyet social-ligjore të humanizmit, ri-integrimit social, rehabilitimit social, ndryshimeve pozitive në jetën e të dënuarve, arritjes së standardeve evropiane në sistemin penitenciar, si dhe legjitimitetit të duhur kushtetues-ligjor në vendet e vuajtjes së dënimit, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, u miratua ligji “Për dhënie amnistie”. Aplikimi i amnistisë përveçse ndikoi drejtpërsëdrejti në përmirësimin e kushteve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, uljes së mbipopullimit, u konceptua edhe si një akt për

të rivendosur dinjitetin e të dënuarve. Zbatimi i amnistisë filloi më 10 prill 2014. **813** persona, përfituan nga ligji i amnistisë në Sistemin e Burgjeve. Numri i personave të liruar që përfituan nga amnistia, të ndarë sipas veprave penale, paraqitet në tabelën e mëposhtme:


Tab. 2 Numri i personave që përfituan nga amnistia sipas neneve të Kodit Penal

Nenet e Kodit Penal							
134	88/1	139	283	130	278	76	Të tjera
246	34	35	124	37	37	51	249

Siç vihet re nga të dhënat në tabelë, pjesa më e madhe e të burgosurve përfituan nga neni 134 i Kodit Penal (246 persona), neni 283 (124 persona), neni 76 (51 persona), neni 130 dhe 278 (37 persona për secilin nen) dhe neni 139 (35 persona). Nenet e tjera të amnistuara kishin një numër më të ulët të personave që përfituan.

Të ndarë sipas grup moshave, pjesa më e madhe e të dënuarve që përfituan nga amnistia, por që në të njëjtën kohë përbëjnë dhe numrin më të madh të dënuarve në burgje, i përkasin grupmoshës 30-40 vjeç, për të vijuar me grupmoshën 25-30 vjeç. Referuar grupeve vulnerabël në sistem si të miturit dhe gratë, përfituan 23 të mitur dhe 25 gra.

Tab. 3 Ndarja e të dënuarve që përfituan nga amnistia sipas grupmoshave



4.2 Probabiliteti i ri-përfshirjes në sjellje kriminale

Probabiliteti i matjes së ri-përfshirjes në sjelle kriminale të personave të cilët përfituan nga amnistia është kryer bazuar në të dhënat që disponojnë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Për një studim të mirëfilltë shkencor, do të ishte e nevojshme matja dhe vlerësimi i të dhënave dhe sjelljes së të burgosurve, të paktën për një periudhë tre mujore nga data e lirit. Në kushtet e konceptimit të këtij studimi dhe objektivin kryesor për të hedhur bazat e studimeve të mëtejshme për kërkime dhe studime periodike mbi recidivizmin e personave të cilët lirohen nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, janë marrë në konsideratë dy elementë:

1. Historitë e mëparshme të recidivizmit të personave që përfituan nga amnistia;
2. Kushtet social ekonomike.

Të dhënat e mbledhura rreth personave të cilët përfituan nga amnistia, tregojnë se nga 813 persona të liruar, 234 persona kanë qenë recidivistë, prej të cilëve 132 recidivistë specifik dhe 102 recidivistë të përgjithshëm, prej të cilëve 10 të mitur dhe 3 gra. Të dhënat e vitit 2014, tregojnë se ka një tendencë në rritje të personave të cilët rikthehen në burg për kryerjen e të njëjtës vepër penale.

Tab. 4 Ndarja e të burgosurve që përfituan nga amnistia me sjellje recidiviste

IEVP	Kavajë	Vaqarr	Ali Demi	Fushë Krujë	Lushnjë	Burrel	Korçë	Peqin	Rrogozhinë	Lezhë	Jordan Mísja	Durrës	Vlorë	Totali
Recidivistë të Përgjithshëm	3	5	7	9	10	3	13	10	10	16	2	8	0	102
Recidivistë Specifik	7	14	10	9	12	4	23	19	9	24	2	1	3	132

Referuar kushteve social ekonomike të personave të cilët u liruan, sipas të dhënave të mbledhura në dosjet personale të dënuarve dhe bazuar në deklaratimet individuale të personave me liri të kufizuar, për qëllime të një studimi më të hershëm⁸, 59% e tyre, kishin një nivel të ulët ekonomik dhe vinin nga një status me nivel të ulët shoqëror, duke mos përjashtuar nivelin e edukimit. Pjesa tjetër e të liruarve, rreth 21%, nga deklaratimet personale, referonin se vinin nga niveli i mesëm shoqëror dhe kishin të ardhura të

⁸ Studim mbi nivelin shoqëror dhe ekonomik të paraburgosurve dhe dënuarve në Sistemin e Burgjeve, prill 2014

mjaftueshme për të përballuar jetesën. Megjithatë, mbetet për tu vlerësuar se çfarë kuptohet me të ardhura të mjaftueshme nga personat me liri të kufizuar. Për pjesën tjetër të liruarve nga amnistia, nuk kishte të dhëna të sakta.

Veprat dominuese të njëjta për të cilët personat janë ri-arrestuar dhe ri-dënuar përfshijnë, vjedhjen, dhunën në familje, plagosje, armëmbajtje pa leje dhe shkatërrim prone.

Bazuar në këta faktorë, por edhe mundësive të pakta për rehabilitim të suksesshëm në shoqëri të personave të cilët lirohen nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kushtet social-ekonomike, por edhe stereotipave negative dhe stigmatizimit nga shoqëria të kësaj kategorie, veçanërisht për personat të cilat janë përsëritës të kryerjes së të njëjtës vepër penale apo të ndryshme, mund të përlllogaritet se brenda tre viteve rreth 30% e personave të liruar nga amnistia, mund të kthehen në burg.

Përlllogaritja është bërë bazuar në numrin e personave të cilët përfituan nga amnistia dhe numrin e personave të cilët kanë qenë recidivistë dhe kanë nivel nën standard ekonomik.

V. KONKLUZIONE/REKOMANDIME

Qëndrimet e shoqërisë ndaj personave të cilët lirohen nga burgju, luajnë një rol në normat e recidivizmit. Në disa raste, edhe pse personi ka përfunduar dënimin për shkeljen e kryer, shoqëria vazhdon post-ndëshkimin e tij, duke dekurajuar personin. Shumë individë të shoqërisë refuzojnë të besojnë se personat të cilët kanë përfunduar dënimin, mund të ndryshojnë, duke demonstruar mosbesim të vazhdueshëm. Ky lloj qëndrimi ndikon negativisht në qenien psiko sociale të personit të liruar nga burgju, veçanërisht te të miturit dhe të rinjtë, i cili “motivohet” të sillet për të vepruar sikurse perceptohet nga shoqëria.

Megjithatë, Sistemi i Burgjeve dhe i Drejtësisë Penale në përgjithësi, ka një rol të konsiderueshëm dhe kyç në uljen e recidivizmit. Për të përmirësuar shërbimet në sistemin e burgjeve duhet të mbahet në konsideratë:

1. Procedurat e vlerësimit të burgosurve: Duhet të hartohen dhe implementohen procedura të qarta dhe gjerësisht të zbatueshme në të gjitha institucionet. Ndërhyrjet që janë efektive për reduktimin e recidivizmit ndër autorë të përgjithshëm ka të ngjarë të jetë efektive në të gjithë nëngrupet e ndryshme.

2. Vlerësimet e sjelljes të burgosurve dhe paraqitja e fakteve për vlerësimin e çfarëdolloj aspekti që lidhen me sigurinë, masa lehtësuese për të burgosurin, duhet të jenë të hartuara në mënyrë tejet profesionale dhe bazuar në një vëzhgim periodik të burgosurit.
3. Gjatë hartimit të projektligjit ose iniciativave të tjera ligjore për dhënien e faljes apo amnistisë, ndoshta duhet të vlerësohet nëse personat të cilët përfitojnë nga amnistia kanë qenë ose jo recidivistë dhe llojin e veprës së përsëritur. Nëse numri i personave që janë ri-përfshirë në sjellje kriminale pas lirimit është shumë i lartë, atëherë kemi të bëjmë me dy tregues; mungesa e aftësive të duhura brenda sistemit për edukimin e personave me liri të kufizuar, ose vendimmarrje të gabuara.

Aneks 1

Tabelë me të dhëna mbi veprat e amnistuara, numrin e personave që përfituan sipas Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)

Neni	Veprat Penale e Amnistuara, Numri i Personave sipas IEVP																				
	Kavajë	Vaqarr	Ali Demi (Bura)	Fushë Kruje	Lushnjë	Burrel	Korça	Peqini	Rrogozhinë	Tepelenë	Lezhë	Krujë	Ali Demi (Gra)	Jordan Misja	Durrës	Berat	Vlorë	Mine Peza	Elbasan	Spitali i Burgut	Shuma
134	17	15	22	18	19	4	35	56	19	2	38		5	3	1	1	7	3	3	1	269
88/1		3	2	4	3	3	4	4	4		7										34
323		2						1								1					4
33/1							1				1										2
190/1									1												1
143		2	1	3	1		3	2			1		8								21
301					2			1													3
150		1			1			1			1										4
121/a			1					1						2							4
300			1																		1
100/2	1						2														3

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
RI-PËRFSHIRJA NË SJELLJE KRIMINALE TË PERSONAVE QË PËRFITUAN NGA LIGJI I AMNISTISË- QERSHOR 2014

321		1	1	1	1					1									5
139	4	3	2	8	5	1	4		3	5									35
140	1	4		1	3	1	1	1	3	6									21
141		2		1		1		2		3					1				10
76		3		5	5	3	3	12	2	11	2	2			3				51
78		1		2	3		1		1	1	2	1	1						13
290		1	4	2			3	2	3	1	4				1				21
283		9	9	7	20	1	11	38	12	1	15		1						124
284		1	2	4				2					1						10
135		2	1		2					1		1							7
130		1	2	1	4		10	6	2	9						1		1	37
287		1	2																3
186			2		2			8	2	2	1								17
82		1	1							2									4
151		1														1			2
298/2			1						1										2
85			1		2														3
114			1		1		3	3	2				3						13
248/1			1																1
109/b				1	2			1		4									8
278				1	1	5	3	7	6	9			1			1	3		37
84						1				2									3
237				1															1
101				2				3											5
79						1	1			1									3
292				1				1											2
236							2	1	1										4
108							1	1											2

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
RI-PËRFSHIRJA NË SJELLJE KRIMINALE TË PERSONAVE QË PËRFITUAN NGA LIGJI I AMNISTISË- QERSHOR 2014

90											1										1
129											1										1
83						1									1						2
189											1	1									2
326											6										6
102								1			1										2
248											1										1
199										1											1
113													1	1							2
128													1								1
183							1														1
156									1												1
126									1												1
110																1					1
Shuma	23	54	57	63	77	22	89	155	64	7	134	4	25	5	8	3	9	6	4	1	813